

MONUMENTET E KULTURËS TË KULTIT KATOLIK NË QARKUN SHKODËR E LEZHË - RREZIQET E SOTME

Dr. Dom Nikë UKGJINI
Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Objektet e kultit i kanë fillimet e jetës në periudhën antike, kur themelohen si të tilla për nevojat e bashkimit të besimtarëve në një vend të caktuar për t’iu lutur Zotit. Jeta dhe pamja e tyre me themelet e lashta ka vazhduar të ndjekë kurbën e ngjarjeve historike gjatë gjithë periudhave pasuese të zotërimit romak, antikitetit të vonë dhe mesjetës. Këtë traditë e kanë konfirmuar si burimet historike ashtu edhe të dhënat arkeologjike, për Shkodrën, Lezhën e shumë qytete të tjera në Arbëri. Shkodra dhe Lezha, për të cilat po bëjmë fjalë, që në shek. III-IV, përmenden si nyje të rëndësishme e dy rrugëve të njohura të kohës nga Salona (Spliti i sotëm) për në Durrës (Dyracio), për të vazhduar më pas për Naissus (Nishin i sotëm), për të cilat ka edhe mjaft gjurmë arkeologjike.¹

Fjalë kyçe: qark, objekt kulti, monumente, traditë, fe, rrënoja.

ABSTRACT

The objects of worship have their origins in life in the ancient period, when they were established as such for the needs of uniting the believers in a certain place to pray to God. Their life and appearance with ancient foundations has continued to follow the curve of historical events throughout the subsequent periods of Roman domination, late antiquity and the Middle Ages. This tradition has been confirmed by both historical sources and archaeological data, for Shkodra, Lezha and many other cities in Arber. Shkodra and Lezha, which we are talking about, since the century. III-IV, are mentioned as important junctions of the two known roads of the time from Salona (today's Split) to Durrës (Dyracio), to continue later to Naissus (today's Nis) for which there are many archaeological traces.

Key words: region, cult object, monuments, traditions, religion, ruin.

MONUMENTET E KULTURËS TË KULTIT KATOLIK NË QARKUN SHKODËR E LEZHË - RREZIQET E SOTME

Një nga proceset më mbresëlënëse të kësaj periudhe është dhe përhapja e fesë së re, krishtërit. Ndërsa burimet historike si korrespondenca e papëve, fillojnë të flasin për herë të parë në shek. IV për Shkodrën e shek. VI, për Lezhën. Në shek. e IX, në koncilin e *Delmitanus*, dhe sidomos në fund të shek. XI (1089), papati përmend të gjithë ipeshkvijnjtë e Arbërisë Veriore si: Tivarin, Shkodrën, Lezhën, Durrësin e dioqezat të tjera në Arbëri.² Kjo nënkupton, si organizimi kishtar dhe objektet e tyre ndërtimore, krahasoheshin me objektet e kultit të stilit romanik e gotik, që shkëlqenin në botën perëndimore, për të vazhduar kështu edhe gjatë principatave Arbërore në shek. XIII-XIV. Në kushtet e kërcënimit të vazhdueshëm të rrezikut osman, mjaft prej feudalëve vendas në fund të shek. XIV e fillim të shek. XV, i drejtohen Venedikut, duke ua dorëzuar gradualisht qytetet dhe me to edhe objektet kishtarë. Pas pushtimit përfundimtar turk në fund të shek. XV, ndodhin një sërë zhvendosjesh

¹ Gëzimi Hoxha, Luan Perzhita, Flavio Cavalini, *Monumentet e Kultit të Krishterë në Dioqezën e Lezhës*, Dioqeza e Lezhës, Lezhë, 2007, f. 20.

² Nikë dr. Dom Ukgjini, *Kisha katolike në Trevat Shqiptare, (Nga shek. XI-deri sot)*, Qendra Botuese, Shoqata Jezuite, Botues, Gjergj Fishta Lezhë, 2016, f.49.

të selive ipeshkvore për në pjesët malore dhe rrënimet e shndërrimit në xhami të shumë objekteve fetare në të gjitha trevat shqiptare e sidomos kur fjala bie për Shkodrën e Lezhën.³

Gjendja e objekteve kishtare në shek. XVII, na bëhet më e qartë në saj të informacioneve që marrim nga raportet kishtare nga Marin Bici në vitin 1610, Pjeter Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, e në vitin 1703, nga Vinçenc Zmajeviq i cili në Kuvendin e Arbrit na informon ndër të tjera hollësisht për gjendjen e mjerueshme të kishave me afreske murale, në dioqezën e Shkodrës e Lezhës, të shkatërruar nga turqit osmanllinj.⁴ Pas fillimit të shkatërrimit të Perandorisë osmane në shek. XIX, shënohet, ringritja mbi rrënojat e vjetra e meremetimi i shumë kishave e manastireve, në fshatra të kohës mesjetare si dhe ndërtimi i Kishave katedrale, për dioqezën e Lezhës në fshatin Kallmet, në vitin 1845, në Shkodër në vitin 1865 dhe në vende të tjera. Gjatë luftërave Ballkanike e luftës së parë botërore, shënohen dëmtimet e disa objekteve fetare, në rrethin e Shkodrës dhe Lezhës, të cilat sipas relacionit të delegatit Apostolik Ernesto Koci të vitit 1918, përsëri u deshën të meremetoreshin. Në vitet në vazhdim, këto objekte nuk patën trazime të theksuara, pos nevojës për mirëmbajtje të zakonshme nga degradimet e kohës.⁵

Me mbylljen e kishave dhe ndalimit të fesë në Shqipëri në vitin 1967, këto objekte më rëndësi historike pësuan goditje të rëndë. Me një të rënë të lapsit, diktatura dhunoi e përdhosi brenda një viti çdo gjurmë të trashëgimisë fetare e kulturore në vend. Objekte kulti në Veri të Shqipërisë, qenë shndërruar në stallë bagëtish, vend grumbullimi bujqësor, vatër kulture e depo ushtarake dhe disa Kisha monumentale i hodhën në erë me lende eksplozivëve, si: Kisha romano-gotike, e shek. XII e Shën Marisë në Vaun e Dejës; e Shën Nikollës në Kakarriq, Lezhë, e shek. XII Shën Ndout në Sebaste të Laçit, po e shek. XIII dhe ajo e Shën Eufemisë në Kallmet të Lezhës e shek. XIII. Regjimi diktatorial, pasi hoqi një numër të madh nga lista e monumenteve pa i dokumentuar, studiuar e filmuar fare duke i zhdukur pa lënë asnjë gjurmë, mendoi sidoqoftë që disa objekte kulti duheshin ruajtur si monumente kulture. Për secilin objekt specialistët e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, që i kanë shqyrtuar me kujdes, japin argumentet dhe vlerat e tyre duke theksuar se duhen ruajtur si pasuri e trashëgimisë sonë. Në ruajtjen e monumenteve specialistet janë nisur jo vetëm nga periudha e vjetërsisë, si periudha para turke të shekujve XIII-XV, por në radhë të parë nga rëndësia e tyre për njohjen dhe studimin e historisë së arteve figurative shqiptare dhe për historinë e kulturës sonë në përgjithësi.⁶

Evidentimi i Monumenteve të kultit katolik, gjendja dhe rreziqet e sotme

Në listën që patën fatin t'i shpëtojnë rrënimin në vitin 1967, në qarkun e Shkodrës dhe Lezhës, duke u shpallur ato Monumente Kulture në vitin 1973 e 1984, në qarkun e Shkodrës qenë: Kisha e Shën Shtjefnit në kalanë e Shkodrës; rrënojat e kishave Trikonkëshe, në Kalanë e Drishtit; Kishat në Shurdhah (Sardë); rrënojat e kishave në kalanë e Nenshatit, Vau i Dejës; rrënojat e kishave në Balezit, Reç, Malesia e Madhe; rrënojat e kishave në kalanë e Dalmacisë në Koman; muret e kishave në Kabash, Fushë Arrëz; Kisha e Shën Mërisë, Vau të Dejës; rrënojat e Kishës së Shën Gjinit në Rushkull, Gruemirë, Malësia e Madhe; rrënojat e kishës së Shën Markut në kalanë e Vaut të Dejës; rrënojat e kishës së Shën Nikollës në Shat (Mazrek); rrënojat e kishës së Shën Shirqit e Bakut në Dajç

³ Po aty, f.104-118.

⁴ Vinçenc P. Malaj, *Kuvendi i Arbënit*, Botimi i Dytë, Shoqata "Don Gjon Buzuku"; Ulqin-Tuz, 1999, f. 80-83.

⁵ Gjergj Gashi, *Vatikani dhe Arbëria (1700- 1922)*, Onufri, Tiranë, 1998, f. 313-452.

⁶ Admirina Peçi, *Relacion i vitit 1967, si shkatërroi rrëgjimi 200 kisha e xhami monument kulture*, gazeta, Shqiptarja.com, Dossier, Tiranë, 14 prill 2014.

të lumit Buna; rrënojat e Kishës së Shën Mëhillit, në kalanë e Sapës, Vau i Dejës.⁷ Në qarkun e Lezhës gjate kohës së monizmit qenë shpallur Monumente Kulture: rrënojat e kishës në kalanë e Sebastit, në Laç, Kurbin; Kisha e Shën Barbarës (Premtës) në Pllanë; muret e kishës e Shën Aleksandrit në Bokianë, Spiten; Kisha e Shën Premtes, në Balldre; Kisha e Shën Nikollës në Zejmen; Kisha e Manastiri në Rubik; muret e kishës së Shën Shtjefnit në Blinisht, rrënojat e kishës e Shën Mërisë në Shën Mëri, Mamuras, Kurbin.⁸

Pas vitit dymijë, Ministria e Kulturës, shpalli në mbrojtje të shtetit: Kompleksin, Kishë e qelë, në Kukël, Bushat, në vitin 2012, rrënojat dhe muret e Kishës katedrale të Sapës në Nenshatë dhe Kisha e Zojës së Papërlyer me Kolegji Françeskan i Troshanit në vitin 2016. Ndërsa në qarkun e Lezhës, godinat e Arqipeshkvisë së Durrësit në Delbnishtë, Milot në vitin 2015 dhe muret dhe rrënoja të kishës së Shën Premtës dhe e selisë ipeshkvore të Arbenisë në Gallatë, Kurbin, në vitin 2016. Në këto vite janë shpallur katër zona të mbrojtura, Kisha e Zejmenit, Balldrës, Rubikut dhe Gallatës në Kurbin.⁹ Pas hyrjes së demokracisë në vitin 1991, dhe organizmi i Kishës katolike në vitin 1993, dioqeza e Shkodrës dhe e Lezhës, si dhe të gjitha dioqezat të tjera në Shqipëri, objektet e kultit të cilat ishin në gjendje rrënimi, një pjesë prej tyre u meremetuan dhe u rindërtuan nga Kisha. Por, pjesa tjetër mbeten si detyrë e në mëshirën e fatit të Ministrisë së Kulturës. Gjatë kësaj kohe të demokracisë, kur pritej një ndërhyrje radikale në përmirësimin e gjendjes në objektet kulturore e sidomos atyre të kultit, realiteti tregon të kundërtën. Gjendja e tyre dita e ditës vetëm sa është përkeqësuar.

Qarku i Shkodrës

Monumentet e Kulturës, ato të kultit katolik në qarkun e Shkodrës, sipas inspektimit në terren, është jashtëzakonisht e rëndë dhe e pa pranueshme, për shkak të mos ndërhyrjes në meremetimin e tyre më vite më radhe. Edhe në ndonjë objekt që është ndërhyrë në mënyrë të pjesshme, ajo ka qenë me cilësi shumë të dobët, dhe vetëm sa për ta arsyetuar fondin e marrë nga shtetit. Ecim sipas një kronologjie të monumenteve të shek. XII-XIII.

Kisha Katedrale e Shën Shtjefnit, në kalanë e Shkodrës me një vlerë të jashtëzakonshme historike e cila i ka muret e ngritura dhe harqet, ndërhyrja e parë dhe e fundit ka qenë në vitin 1988, pra në kohën e monizmit. Në rrënojat e kishave Trikonkëshe, në Kalanë e Drishtit, nuk mbahet mend që ka pasur ndonjë ndërhyrje restaurimi të tyre, pos që kohë pas kohë në ato ambiente ka pasur gjurmime të ndryshme arkeologjike. Po të njejtin fat të keq kanë pasur rrënojat e kishës së Shën Nikollës në Shat (Mazrek). Kishat në Shurdhah (Sardë), ku disa prej tyre akoma i kanë një pjesë të mureve deri në 4 metra lartësi, nuk kanë pasur trajtime restauruese, pos disa rrënojave me pak vlerë më një fond Evropian në vitin 2014. Për shkak të moskujdesit nga shtetit në Shurdhah (Sardë), famullitari i zonës në vitin 2002, i ka ngritur muret e Kishës së Zojës së Bekuar duke e mbuluar me çati. Ndërhyrje në meremetimin e rrënojave apo gjysmë mureve ekzistues të monumenteve, gjatë këtyre 30 viteve, nuk ka pasur as në rrënojat e kishave në kalanë e Nenëshatit, Vau i Dejës; rrënojat e kishave të Balezit, Reç, Malësia e Madhe, rrënojat e kishave në kalanë e Dalmacis në Koman, pos disa gjurmimeve arkeologjike për efekt studimi muret e kishave në Kabash, Fushë Arrëz; Kisha e Shën Mërisë, Vau të Dejës, rrënojat e Kishës së Shën Mëhillit, në kalanë e Sapës, Vau i Dejës. Në mungesën e kujdesit nga shteti, famullitari i zonës së Gruemirës, Vrakë, është kujdesur për rrënojat e abacisë dhe Kishës së Shën Gjinit e shek. XII, në Rushkull, Gruemirë, Malesia e Madhe. Po aty famullitari e ka rikonstruktuar dhe meremetuar, kambanaren e madhe deri në 7 metra lartësi në vitin 2012. Në rrënojat

⁷ Instituti i Monumenteve të Kulturës, *Lista e Monumenteve të Kulturës*, Tiranë, 2017.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

e kishës së Shën Markut në kalanë e Vau të Dejës, nga famullitari i zonës janë ngritur muret e kësaj Kisha dhe është vendosur çatia në vitin 2004. Rrënojat e kishës së Shën Shirqit e Bakut në Dajç të lumit Buna, apo abacia benediktine e shek. VI, nga moskujdesi i shtetit rrezikon të zhduket përgjithmonë. Studiuesit tanë në sensin e ngritjes së alarmit shprehen “Bizhuja e humbur e Shirqjit. Kjo kishë e stilit romano - gotike e rindërtuar në shek.XIII, e cila strukturën e plotë të saj e kishte që në vitet 1900, sot e mbetur me një mur ballor, në pritje të një mëshire nga qielli, për mirëmbajtjen e saj. Meqenëse ky mur vazhdimisht është i rrezikuar edhe nga ujërat e lumit Buna, Ministria e Kulturës, në viti 2013 ka ngritur disa argjinatura mbrojtëse ndaj gërryerjes së tokës nga ujërat dimërore dhe përmbytjet, por ato nuk janë të mjaftueshme për jetëgjatësinë e saj. Për shkak të dobësisë të themeleve nga ujërat e vazhdueshëm aty pranë, muri ekzistues e ka krijuar një plasje për në mes dhe dita ditës rrezikon të bie. Një meremetim i thjeshtë e jo profesional i murit është krye në vitin 2016, nga Ministria e Kulturës, por ajo nuk mjafton për ta mbajtur në jetë atë mur me një histori qindra vjeçare.¹⁰ Kompleksin, kishë e qelë, në Kukës, Bushat, ku poeti Mjeda ka jetuar për 30 vite me radhë, është ringritur dhe restaurua me fonde private nga famullitari i zonës Dom Nikë Ukgjini gjatë vitit 2012-2014.¹¹ Për shkak të vlerave historike dhe arkitekturore që ka në vitin 2012, sa për evidentim qe shpallur Monumente Kulture. Po kështu sa për evidentim, qenë shpallur edhe rrënojat dhe muret e Kishës katedrale të Sapës në Nenshatë në vitin 2016.

Qarku i Lezhës

Po kështu gjendja e alarmuese situata është edhe në qarkun e Lezhës. Në qarkun e Lezhës u bënë disa ndërhyrje, rindërtuese dhe restauruese nga ana e Ministrisë së Kulturës, në katedralen e Shën Nikollit dhe njëkohësisht vendvarrimi i Gjergj Kastriotit, ku ajo e fundit ndodhi në vitin 2018. Nëse i radhisim sipas rendit kronologjike objekte të tjera, duhet të nënvizoj problematikat e shumta të Kishës mesjetare të Balldrenit e shek.XIII, e stilit gotik. Kisha e Balldrenit më vlera kaq të mëdha historike e artistike, si për çudi, në lidhje më afresket, në pjesën e absidës dhe gjurmë të tjera në tërë hapësirën e mureve, për vite të tëra kishte mbetur jashtë vëmendjes të diplomatëve studiues, austro-hungarezë, franceze, italian e tjerë si: Hahn, Ippen, De Grand, Jeriçek, Shuflaj, apo jezuitit skrupuloz, Zef Valentinit.¹²

Madje, edhe studiuesit tanë që kontribuan për shpalljen Monument Kulture të Kategorisë së parë për vlera arkitekturore, në vitin 1981, nuk e hamendësonin së brenda saj fshihej një pasuri e madhe qindra vjeçare me vlera jo vetëm shqiptare por dhe ballkanike. U desh të vijë viti 2002, kur në një aksion të hartuar nga Ministria e Kulturës për shpëtimin e pjesës arkitekturore, rastësisht u zbulua brenda suvatimit kjo pasuri e rrallë artistike e ideuar nga mendja arbërore. Një projekt tjetër i hartuar nga Ministria e Kulturës në vitin 2005 edhe pse ishte shumë ambicioz për rehabilitimin e plotë të këtij objekti, ai kishte mbetur i fjetur në sirtarët e kësaj Ministrie, ndërkohe që objekti, po shkatërrohej në të gjitha drejtimet e mundshme. Nisur nga gjendja e mjerueshme e këtij objekti, situatën në dorë e mori, Dom. Nikë Ukgjini dhe sipërmarrësi Gjergj Lejzeza, dhe me ndihmën e kontribuesve të tjerë privatë, u arrit që objekti të restaurohet dhe rikonstruktohet i plotë në vitin 2019, duke vendosur çatinë e re, dyer, dritare dhe zbulimin gjurmëve të afreske në muret e brendshme. Mbetet nevoja e restaurimit dhe

¹⁰ Nikë dom Ukgjini, *Kisha e Shirqit dëshmi 1500 vjeçare*, gazeta Dita, Tiranë, 21 prill 2019.

¹¹ Nikë dom Ukgjini, Qendra Muzeore Ndre Mjeda, vend takimi gjithë kombëtar, në: Ndre Mjeda 150 vjetori i Lindjes, Konferencë Shkencore, organizua nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, f. 161-169.

¹² Valeria Dedaj, *Restaurimi i Kishës së Shën Premtes, Dom Nikë Ukgjini: Afresku i ngjashëm me 'darkën e fundit' të Da Vinçit*, Report TV. 19 nëntor 2019; Nikë dom Ukgjini, *Kisha e Balldrenit sipas relacioneve të Ipeshkvijve të Lezhës*, Milosao, Gazeta Shqiptare, 22 dhjetor 2019.

konservimit të afreskeve murale në pjesën e absidës.¹³ Po e njëjta gjendje ishte dhe në Kishën e Shën Barbarës (Shën Barbullës) e shek. XIII, në fshatin Pllanë. Afresket e saj impresionuese, brenda e jashtë, në pjesën e hyrjes, po shpërlahen gradualisht si rezultat i mungesës së ndërhyrjeve dhe sidomos lagështirës së shkaktuar nga amortizimi i çatisë për gjatë 18 viteve me radhë. Ndërhyrjet e fundit në këtë objekt u bënë nga Ministria e Kulturës në vitin 2001-2002, duke vendosur një çati provizore mbi atë vjetrën, dhe sistemimi i dyshemesë. Më pas ajo që braktisur plotësisht nga Ministria e Kulturës, duke e lenë pa dyer e dritare e më çati të shkatërruar.¹⁴ Në këtë rast u pa nevoja e domosdoshme e një ndërhyrje të shpejt në baza vullnetare gjë që u bë nga Dom Nikë Ukgjini e sipërmarrësi Gjergj Leqejza si dhe disa sipërmarrës të tjerë, dhe në fund të vitit 2020, u arrit të bëhet rikonstruktimi i plotë i objektit: çati të re, dyer e dritare, duk përsirë këtu sistemimin e ambientit për rreth dhe përkujtimoren për shkollën shqipe. Mbetë nevoja e konsolidimit dhe konservimit të afreskeve murale të cilat akoma e ruajnë shkëlqimin e tyre.¹⁵

Kisha e Shën Aleksandrit (Sh'Lledrit) në kodrën e Bokionit, e cila ndodhet midis fshatrave Spiten dhe Pruell, ka qenë kthyer në gërmadhë nga mos kujdesi i Ministrisë së Kulturës, por në vitet 2010-2011 këtu kanë ndërhyrë vetë banorët së bashku me priftin famullitar, duke ringritur në këmbë muret e rrafshuara në përjashtim të 50% të absidës, duke vendosur çatinë e re, dyer, dritare dhe sistemim i ambientit për rreth objektit.¹⁶ Në lidhje me Kishën mesjetare të Shën Shtjefnit në fshatin Blinisht, me tavan harkor me material guri, këtu është ndërhyrë pjesërisht nga ana Ministrisë së Kulturës sa për t'ia mbushur mendjen ndokujt se po punohet dhe për t'i arsyetuar shpenzimet e bëra. Aktualisht vetëm 60% e strukturave murale janë në këmbë, prandaj është shumë e nevojshme edhe një ndërhyrje konservuese, konsoliduese, restauruese dhe ngritja e një çatie provizore, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë hyrjes së Kishës, absidës dhe asaj çfarë ka mbetur nga muri verior.¹⁷

Kisha e Shën Nikollit në fshatin Zejmen e shek. XIII, e ka humbur plotësisht madhësinë e saj të dikurshme. Pasi ka mbetur pa çati, reshjet atmosferike kanë shkaktuar dëmtimin, zhbërjen dhe fshirjen e plotë të afreskeve dhe rënien e suvasë, duke ekspozuar kështu të gjithë muraturën e brendshme. Gjatë udhëtimit të tij në vitin 1907, Theodor Ippen (diplomati dhe albanolog) ka konstatuar në faqen e majtë të murit të kësaj kishe, gjurmë të qarta afreskesh ku paraqitej Shën Maria e ulur në fron që mbante në prehër Jezu-Krishtin. Nga mos kujdesi i Ministrisë së Kulturës, në muajin janar të këtij viti u shemben dy muret anësore duke u shndërrua në një gërmadhë.¹⁸ Kisha dhe Manastiri i Rubikut të shek. XII, falë mirëmbajtjes së etërve françeskan të cilët edhe sot kujdesen për te, në vitin 1998 ka qenë rikonstruktuar nga françeskanët me mjaft sukses. Ajo tani ka nevojë për konsolidimin e gjurmëve të afreskeve që gjenden në pjesën e absidës të cilat kanë qenë skajshëm të dëmtuar nga acidet luftarake të depozituar në afërsi të objektit në kohën e komunizmit. Kjo gjë ka mundur të bëhet nga Ministria e Kulturës, me rastin e restaurimit të fundit në vitin 2021 më fondet Evropiane.

Në vazhdën e atyre që po zhduken e rrënohen, janë dhe rrënojat të kohës antike, të Kishës së Shën Marisë në Shënmri, Mamuras, Kurbin, ku në disa pjesë të mureve ekzistuese e gjysmë të shkatërruara,

¹³ Nikë dom Ukgjini, *Kisha e Balldrenit sipas relacioneve të Ileshkvijs të Lezhës*, Milosao, Gazeta Shqiptare, 22 dhjetor 2019; Reshat Gega, *Kisha e katandisur në depo kooperative, si i kthym shkëlqimin Shën Premtes*, gazeta Panorama, Tiranë, 11. Gusht 2020.

¹⁴ Nikë dom Ukgjini, *Krishtlindje me rivlerësimin e kishës-shkollë*, Gazeta Shqiptare, online, 25.XII. 2020.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Valeria Dedaj, *Apeli, po rrënohet Kisha e Shën Barbarës dhe 6 monumente në Lezhë!* Gazeta Shekulli, 10 dhjetor 2018.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Frank Shkreli, *Shembet Kisha 700 vjeçare në Zejmen të Lezhës*, gazeta Telegraf, 26 janar 2020, f.10-11.

akoma janë të dukshme gjurmët të afreskeve mesjetare të cilat nuk do i kemi më. Në fshatin Gallat, Kurbin, kemi rrënojat e Kishës së Shën Premtes dhe Selisë ipeshkvore të Arbenisë, të cilat janë të pa konsoliduar. Këtu në vitin 2013, nga vetë banorët së bashku me priftin e zonës kanë ndërhyrë duke ringritur në këmbë muret gjysmë të rrafshuara duke vendosur çatinë e re, dyer, dritare.

Një ansambël ndërtimor e shek. XIX, shpallur Monumente Kulture në vitin 2016, është dhe Selia e vjetër e Durrësit në Delbnishtë, Kurbin, e cila në vitin 2005, qe meremetuar nga famullitari i zonës, për sot është në rrenim e sipër për arsye të dëmtimit nga tërmeti i vitit 2019. Kisha e Zojës së Papërlyer dhe Kolegji Françeskan i Troshanit, ndërtuar në shek. XIX, janë një ansambël ndërtimor madhështor i shpallur si Monument Kulture në vitin 2016, dhe gjendja fizike është e mirë nga rikonstruktimi i bërë në vitin 1995, nga famullitari i zonës.¹⁹

PËRFUNDIME

1. Në qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës, vërehet dhe mungesa e evidentimit të shumë objekteve të kultit me vlera konsiderueshme historike, kulturore e fetare.
2. Në mungese të dorës së shtetit, shumë objekte të kultit *Monument Kulture* kanë rënë pre e gërmimeve pirate gjatë vitit 2007 dhe këto raste janë bërë publike në Media nga vetë banorët e revoltuar. Gjithashtu nga heshtja e braktisja e monumenteve, banorët në shumë zona, kanë dëmtuar sitet arkeologjike duke ngritur varre pranë themeleve e objekteve të caktuar.
3. Nga Ministria e Kulturës, jo vetëm në këto raste, por në gjithçka që ka lidhje me Trashëgiminë Kulturore në përgjithësi dhe për Monumentet e Kulturës në veçanti, presim që ky institucion kaq i rëndësishëm të kryejë funksionin për të cilin është krijuar, pra mbrojtjen, përkujdesjen dhe promovimin e çdo aseti të
4. Trashëgimisë tonë Kulturore Kombëtare.²⁰ Monumentet e Kulturës përfaqësojnë vertebrat e shtyllës kurrizore të identitetit tonë kombëtar dhe çdo objekt i rrënuar nga mungesa e vëmendjes, harresa, pakujdesia apo nga abuzimet e ndryshme, është krim dhe fatkeqësi kombëtare.
5. Madje Ministria e Kulturës e ka për detyrë të kujdesohet edhe për Monumentet në zonat kufitare të shteteve fqinjë, ku gjenden një numër i madhi objekteve të kulturës sonë kombëtare.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Gëzimi Hoxha, Luan Perzhita, Flavio Cavalini, Monumentet e Kultit të Krishterë në Dioqezën e Lezhës, Dioqeza e Lezhës, Lezhë, 2007, f. 20.
2. Nikë dr. Dom Ukgjini, Kisha katolike në Trevat Shqiptare,(Nga shek. XI-deri sot), Qendra Botuese, Shoqata Jezuite, Botues, Gjergj Fishta Lezhë, 2016, f.49.
3. Po aty, f.104-118.
4. Vinçenc P. Malaj, Kuvendi i Arbënit, Botimi i Dytë, Shoqata “Don Gjon Buzuku”; Ulqin-Tuz, 1999, f. 80-83.

¹⁹ Nikë dom Ukgjini, *Qendër kulturore shtëpia e Fishtës apo Kuvendi i Troshanit*, gazeta Shqiptarja.com, Tiranë, 28 dhjetor 2014.

²⁰ Besi Bekteshi, *Dom Nikë Ukgjini: E rendë të shkatërrohen monumentet, marrëveshjet politike po vënë në rrezik kulturën tonë*, gazeta Sot, Tiranë, 23 maj 2020; Elvis Hila, *Rrënim i monumenteve, historiani Dom Nikë Ukgjini: Lezha në harresë! 26 monumente kulture, vetëm 4 të hapura për vizitorët*, gazeta Shqiptarja.com, Tiranë, 22 mars, 2022.

5. Gjergj Gashi, Vatikani dhe Arbëria (1700- 1922), Onufri, Tiranë, 1998, f. 313-452.
6. Admirina Peçi, Relacion i vitit 1967, si shkatërroi rrëgjimi 200 kisha e xhami monument kulture, gazeta, Shqiptarja.com, Dossier, Tiranë, 14 prill 2014.
7. Instituti i Monumenteve të Kulturës, Lista e Monumenteve të Kulturës, Tiranë, 2017.
8. Po aty.
9. Po aty.
10. Nikë dom Ukgjini, Kisha e Shirqit dëshmi 1500 vjeçare, gazeta Dita, Tiranë, 21 prill 2019.
11. Nikë dom Ukgjini, Qendra Muzeore Ndre Mjeda, vend takimi gjithë kombëtar, në: Ndre Mjeda 150 vjetori i Lindjes, Konferencë Shkencore, organizua nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, , Prishtinë, f. 161-169.
12. Valeria Dedaj, Restaurimi i Kishës së Shën Premtes, Dom Nikë Ukgjini: Afresku i ngjashëm me ‘darkën e fundit’ të Da Vinçit, Report TV. 19 nëntor 2019; Nikë dom Ukgjini, Kisha e Balldrenit sipas relacioneve të Ileshkuvijve të Lezhës, Milosao, Gazeta Shqiptare, 22 dhjetor 2019.
13. Nikë dom Ukgjini, Kisha e Balldrenit sipas relacioneve të Ileshkuvijve të Lezhës, Milosao, Gazeta Shqiptare, 22 dhjetor 2019; Reshat Gega, Kisha e katandisur në depo kooperative, si i kthyem shkëlqimin Shën Premtes, gazeta Panorama, Tiranë, 11. Gusht 2020.
14. Nikë dom Ukgjini, Krishtlindje me rivlerësimin e kishës-shkollë, Gazeta Shqiptare, online, 25.XII. 2020.
15. Po aty.
16. Valeria Dedaj, Apeli, po rrënohet Kisha e Shën Barbarës dhe 6 monumente në Lezhë! Gazeta Shekulli, 10 dhjetor 2018.
17. Po aty.
18. Frank Shkreli, Shembet Kisha 700 vjeçare në Zejmen të Lezhës, gazeta Telegraf, 26 janar 2020, f.10-11.
19. Nikë dom Ukgjini, Qendër kulturore shtëpia e Fishtës apo Kuvendi i Troshanit, gazeta Shqiptarja.com, Tiranë, 28 dhjetor 2014.
20. Besi Bekteshi, Dom Nikë Ukgjini: E rëndë të shkatërrohen monumentet, marrëveshjet politike po vënë në rrezik kulturën tonë, gazeta Sot, Tiranë, 23 maj 2020; Elvis Hila, Rrënimi i monumenteve, historiani Dom Nikë Ukgjini: Lezha në harresë! 26 monumente kulture, vetëm 4 të hapura për vizitorët, gazeta Shqiptarja.com, Tiranë, 22 mars, 2022.